iParticipate

ItaliaHello
Trova. Impara. Realizza.

anelli mancanti firenze

“DIRITTI, LAVORO E PARTECIPAZIONE”

PERCORSI PER L’AUTONOMIA E L’INTEGRAZIONE DEI GIOVANI



TOOLKIT LA CITTÀ È ANCHE TUA

NJË UDHËZUES PRAKTIK PËR T’U ORIENTUAR, PËR TË ZGJEDHUR DHE PËR T’U PËRFSHIRË

Me kontributin e

FONDAZIONE CARLO MARCHI

TETOR 2026

“Diritti, lavoro e partecipazione - Percorsi per l’autonomia e l’integrazione dei giovani” i është drejtuar të rinjve që jetojnë në qytetin e Firences dhe është realizuar nga IParticipate, ItaliaHello dhe Anelli Mancanti falë mbështetjes së Fondacionit Carlo Marchi. Projekti ka ndërthurur formimin gjuhësor, programet e qytetarisë aktive dhe orientimin profesional, duke u ofruar pjesëmarrësve mjete konkrete për të njohur të drejtat e tyre, për t’u orientuar në shërbime dhe mundësi të ndryshme, si dhe për të marrë pjesë në jetën e qytetit.

Ky toolkit është krijuar si një mjet praktik dhe i ripërdorshëm për të mbledhur dhe ndarë materiale, metodologji dhe praktika të mira të testuara gjatë projektit, në mënyrë që njohuritë e fituara të jenë të aksesueshme edhe pas përfundimit të aktiviteteve.

Përmbajtja



HYRJE
NJË HARTË PËR TË FILLUAR



1
TË DREJTAT.
TË DREJTAT E TUA, QYTETI YT
1.1 TË ORIENTOHESH NË QYTET: SHËRBIMET QË KANË RËNDËSI
1.2 TË JESH MIRË: SHËNDETI DHE URGJENCA
1.3 DOKUMENTET DHE LEJET: KUJT T'I DREJTOHESH
1.4 SPORTELET E SHËRBIMIT: KUSH TË DËGJON DHE TË SHOQËRON
1.5 BANESA DHE TRANSPORTI: TË JETOSH DHE TË LËVIZËSH
1.6 KUR DIÇKA NUK SHKON: DISKRIMINIMI DHE DHUNA, KU TË KËRKOSH NDIHMË



2
PUNA.
PUNA NË ITALI, E SHPJEGUAR QARTË
2.1 KONTRATAT, TË DREJTAT DHE RREGULLAT E PASHKRUARA
2.2 TË APLIKOSH PËR NJË VEND PUNE: CV-JA, LETRA E MOTIVIMIT DHE INTERVISTA
2.3 TË KËRKOSH PUNË: KU, ME KË DHE SI
2.4 UDHËZUES PRAKTIK: INTERVISTA E PUNËS, HAP PAS HAPI



3
PJESËMARRJA
TË MARRËSH PJESË DO TË THOTË TË JESH PJESË
3.1 ÇFARË DO TË THOTË TË MARRËSH PJESË?
3.2 KATËR MËNYRA PËR TË MARRË PJESË, PËRTEJ VOTIMIT
3.3 TË MARRËSH PJESË DO TË THOTË EDHE TË JESH SË BASHKU ME TË TJERËT



4
FIRENCE:
GJEJ VENDIN TËND NË QYTET!
KU TË SHKOSH, ME KË TË KONTAKTOSH, ÇFARË DUHET TË DISH

HYRJE

Kur mbërrin në një vend të ri, ose rritesh mes kulturash të ndryshme, shpesh duhet të mësosh dy herë: fillimisht qytetin, pastaj rregullat e tij të pashkruara. Askush nuk të jep një hartë.

Ky udhëzues përpiqet të bëjë pikërisht këtë, por me pjesët e renditura nga dikush që tashmë e njeh rrugën. Brenda tij do të gjesh tri gjëra që zakonisht të vijnë të veçuara, pa një rend të qartë:

- **Të drejtat.** Si të orientohesh në një qytet dhe kujt t'i kërkosh ndihmë kur të nevojitet: shërbimet, sportelet e shërbimit, kujdesi shëndetësor, banesa, transporti. Dhe çfarë të bësh kur diçka nuk shkon.
- **Puna.** Si funksionon puna në Itali, çfarë shkruhet në të vërtetë në një kontratë, si të shkruash një CV dhe ku të kërkosh punë. Do të gjesh gjithashtu edhe ushtrime praktike.
- **Pjesëmarrja.** Si të gjesh njerëz, hapësira dhe shoqata. Sepse të ndihesh si në shtëpi nuk do të thotë vetëm të kesh një leje qëndrimi apo një kontratë pune, por edhe të kesh dikë me të cilin mund të qeshësh, të diskutosh dhe të ndërtosh diçka së bashku.

Në fund gjendet një seksion i veçantë për Firencen, me adresa dhe kontakte që mund t'i përdorësh menjëherë.

Nuk ke pse ta lexosh nga fillimi deri në fund. Hape aty ku të nevojitet, sot ose pas gjashtë muajsh, dhe pjesën tjetër lëre për më vonë. Ky nuk është një udhëzues se si të "bëhesh italian/e" dhe nuk të kërkon të ndryshosh. Ti sjell tashmë me vete gjuhë, histori, aftësi dhe rrjete që askush tjetër këtu nuk i ka.

Ky toolkit shton atë që shpesh mungon: informacionin e duhur, në momentin e duhur.

1. TË DREJTAT
TË DREJTAT E TUA, QYTETI YT



Të njohësh qytetin ku jeton nuk është vetëm një çështje praktike. Është hapi i parë për të bërë të vlefshme të drejtat e tua. Një e drejtë që ekziston në letër, por që nuk di ku ose si ta kërkosh, mbetet e paarritshme.

Të dish ku kërkohet një certifikatë, kujt t'i drejtohesh nëse ke një problem dhe çfarë të bësh në rast emergjence janë informacione që të bëjnë të ndihesh më i/e sigurt dhe më i/e pavarur.
Kjo vlen si kur sapo ke mbërritur në një vend të ri, ashtu edhe kur ke vite që jeton aty.

Shërbimet ndryshojnë nga një qytet në tjetrin dhe, ndonjëherë, edhe nga një bashki në tjetrën. Për këtë arsye, këtu do të gjesh informacionet thelbësore për t'u orientuar: shërbimet shëndetësore, dokumentet dhe lejet, sportelet dhe zyrat publike, banesën, transportin. Si dhe çfarë të bësh nëse përballesh me diskriminim ose dhunë.

1.1 Të orientohesh në qytet: shërbimet që kanë rëndësi

TË DREJTAT



Kujdes me residenza (rezidencën)!

Nuk mjafton të jesh fizikisht në Itali: karta e identitetit kërkohet, si rregull, në bashkinë ku ke rezidencën e regjistruar, pra aty ku figuron e regjistruar adresa jote. Nëse jeton në një vend, por rezidenca jote është e regjistruar diku tjetër, duhet t'i drejtohesh bashkisë ku ke rezidencën (ose fillimisht të rregullosh ndryshimin e rezidencës).

Bashkia:

Zyra e Gjendjes Civile dhe zyrat bashkiake

Bashkia (Comune) është institucioni vendor që administron një qytet dhe territorin përreth tij. Nëpërmjet zyrave të saj, ajo ofron shumë shërbime për personat që jetojnë aty. Ndër zyrat më të rëndësishme janë:

1. **Anagrafe (Zyra e Gjendjes Civile):** është zyra ku regjistrohet vendbanimi dhe ku kërkohen dokumente si karta e identitetit. Shumë certifikata mund të shkarkohen online nga shtëpia nëpërmjet ANPR -së (Anagrafe Nazionale della Popolazione Residente – Regjistri Kombëtar i Popullsisë Rezidente). Para se të shkosh në sportel, kontrollo nëse mund ta kryesh shërbimin online nëpërmjet ANPR-së.

2. **Stato civile (Gjendja Civile):** merret me regjistrimin e lindjeve, martesave, bashkimeve civile dhe vdekjeve.

3. **URP (Ufficio Relazioni con il Pubblico – Zyra e Marrëdhënieve me Publikun):** këtu mund të bësh kërkesa, të raportosh probleme dhe të paraqesësh ankesa. Gjithashtu ofron informacion të përgjithshëm dhe orientim. Nëse nuk di nga t'ia fillosh, mund të nisësh pikërisht këtu.

4. **Shërbimet sociale të bashkisë**: Shërbimet sociale publike kalojnë kryesisht përmes bashkive. Nëse ke vështirësi ekonomike ose familjare, apo nëse ke një aftësi të kufizuar, mund t'u drejtohesh shërbimeve sociale për të marrë ndihmë ekonomike ose lloje të tjera mbështetjeje. Zakonisht, çdo lagje ka shërbimin e vet social territorial: ky është vendi i parë ku mund të bëhet një vlerësim i situatës tënde.

5. **Sporteli informues për emigracionin:** Në shumë bashki ka një sportel ku mund të marrësh orientim për dokumentet dhe shërbimet, zakonisht falas.

Zyra të tjera të dobishme

Poste italiane

- Zyrat postare shërbejnë për shumë më tepër sesa vetëm për dërgimin e letrave dhe pakove.

Këtu mund të:

- aktivizosh SPID-in, identitetin digjital që nevojitet për të hyrë në shumë shërbime publike online;
- paguash fatura dhe taksën e automjetit;
- marrësh letra rekomande dhe komunikime zyrtare.

Shumë zyra postare kanë gjithashtu Sportello Amico, ku mund të marrësh paketën postare për të përditësuar, rinovuar ose kërkuar një dublikatë të permesso di soggiorno (lejes së qëndrimit).

Kujdes!

Që nga viti 2026, SPID-i i Postës kushton 6 euro në vit, që paguhet në rinovimin e parë pas 1 janarit 2026. Provider të tjerë ofrojnë këtë shërbim me pagesë prej kohesh.

Nëse dëshiron ta shmangësh këtë pagesë, CIE është alternativa falas. Për të aktivizuar dhe përdorur CIE-në përmes telefonit inteligjent, duhet të kesh një pajisje me çip NFC dhe aplikacionin *CIE ID*, si dhe PIN-in që të jepet në momentin e aplikimit.

TË DREJTAT

1.2 Të jesh mirë: shëndeti dhe urgjenca

Regjistrimi në Shërbimin Shëndetësor Kombëtar (SSN)

Në Itali, shërbimi shëndetësor publik është universal: kush ka një leje qëndrimi të vlefshme (ose është në pritje të rinovimit të saj) ka të drejtë të regjistrohet në SSN dhe të marrë tessera sanitaria (kartën shëndetësore). Me kartën shëndetësore mund të zgjedhësh një mjek familjeje (mjek i përgjithshëm) ose një pediatër për fëmijët nën 14 vjeç, pa pagesë. Mjeku do të jetë pika kryesore e referimit për çështjet e përditshme shëndetësore dhe për recetat mjekësore.

Edhe personat që ende nuk kanë një leje qëndrimi të rregullt kanë të drejtë të marrin trajtime urgjente dhe thelbësore, përmes:

- Kodit STP (Straniero Temporaneamente Presente – i huaj i pranishëm përkohësisht), i lëshuar nga ASL-ja. Me kodin STP mund të marrësh trajtim urgjent nëse je në rrezik për jetën, trajtime thelbësore dhe trajtime të vazhdueshme për sëmundje afatgjata. Kërkimi i trajtimeve shëndetësore që shpëtojnë jetën nuk sjell automatikisht njoftimin e autoriteteve për qëndrimin e parregullt të personit, përveç rasteve të parashikuara nga ligji;
- Kartës ENI (Europeo Non Iscritto – evropian i paregjistruar), një dokument i përkohshëm shëndetësor i lëshuar nga ASL-ja, i cili u mundëson qytetarëve të BE-së pa rezidencë në Itali të kenë akses në kujdesin mjekësor.

Pronto soccorso (Urgjenca mjekësore)

Pronto soccorso është për emergjenca dhe urgjenca të vërteta: aksidente, dhimbje të forta, situata që rrezikojnë menjëherë shëndetin. Për çdo problem tjetër, fillo duke kontaktuar mjekun e familjes.
Nëse ai nuk është i disponueshëm (gjatë natës, në fundjavë ose në ditët e festave), mund t'i drejtohesh guardia medica (mjekut të rojës).

Mbaj mend! Kur mbërrin në urgjencë, caktohet një kod përparësie, bazuar në rëndësinë e gjendjes dhe JO në radhën e mbërritjes:

- i kuq: emergjencë e menjëhershme;
- i verdhë/portokalli: urgjencë;
- i gjelbër: pak urgjente;
- i bardhë: jo urgjente (shpesh me pagesë përmes ticket-it).

Farmacitë

Në farmaci mund të gjesh ilaçe. Disa ilaçe për shqetësime të thjeshta mund të blihen pa recetë. Për shumicën e ilaçeve nevojitet receta e mjekut.

Me recetë, disa ilaçe janë falas ose me kosto të reduktuar, ndërsa të tjera paguhen tërësisht.
Farmacitë alternohen me turne nate dhe në ditët e festave, kështu që gjithmonë ka të paktën një farmaci në shërbim në zonë. Për të gjetur më të afërtën, shiko njoftimin në derën e çdo farmacie ose kërko online.



TË DREJTAT

Shëndeti i grave: i consultori (qendrat konsultative)

I consultori familiari (qëndrat konsultative familjare) janë shërbime publike, falas ose me kosto të ulët, të krijuara për shëndetin e grave në çdo fazë të jetës. Mund t'u drejtohesh për:

- vizita gjinekologjike;
- kontracepsion;
- ndjekjen e shtatzënisë dhe lindjes;
- mbështetje për prindërimin, menopauzën, parandalimin dhe kontrollet parandaluese (si Pap test).

Shumë qendra konsultative ofrojnë gjithashtu mbështetje psikologjike dhe, në disa raste, ndërmjetësim gjuhësor për personat që kanë nevojë. Nuk nevojitet recetë nga mjeku i familjes për të pasur akses: mjafton t'i drejtohesh drejtpërdrejt qendrës konsultative më të afërt, edhe pa takim, për një informacion të parë.

Consultorio është një shërbim i ndryshëm nga pronto soccorso (urgjenca).

Nëse ndodhesh në një situatë emergjente ose në rrezik të menjëhershëm, telefono 112 ose drejtohu në urgjencë.

1.3 Dokumentet dhe lejet: kujt duhet t'i drejtohesh

Questura dhe Prefettura: a e di ndryshimin?
Të dyja janë zyra shtetërore, por merren me çështje të ndryshme:

- Questura është një nga pikat kryesore të referimit për permesso di soggiorno (lejen e qëndrimit): aplikimin, rinovimin dhe procedura të tjera që lidhen me qëndrimin në Itali.
- Prefettura kryen funksione të ndryshme administrative të shtetit në territor. Mund të merret me disa procedura, si cittadinanza (shtetësia) dhe ricongiungimento familiare (bashkimi familjar).

Nuk duhet t'i bësh të gjitha vetë! Orientimi mes dokumenteve, zyrave dhe procedurave mund të jetë i ndërlikuar. Të dish se cila zyrë merret me secilën çështje të ndihmon të shmangësh gabimet, humbjen e kohës dhe takimet e panevojshme.
Rregullat për emigracionin dhe shtetësinë ndryshojnë me kalimin e kohës dhe varen nga situata jote personale. Para se të paraqesësh një kërkesë ose të dorëzosh dokumente, fol me një sportel të specializuar. Përveç zyrave publike, ka edhe shoqata dhe sportele që ofrojnë informacion dhe orientim. Zgjidh gjithmonë një sportel të besueshëm, me personel kompetent.

1.4 Sportelet: kush të dëgjon dhe të shoqëron

Përveç sporteleve për emigracionin, ka edhe të tjerë, të dobishëm për çështje të ndryshme:

- **Sportele informative**: për një këshillim të parë mbi punën, shtëpinë, familjen ose çështje të tjera ligjore. Shpesh janë falas ose me kosto të ulët.
- **Sportele gjuhësore**: për të mësuar ose përmirësuar italishten. Shpesh janë të lidhura me kurse publike (si CPIA) ose me kurse të organizuara nga shoqata.
- **Qendra të përgjithshme ndihme**: pika ku mund të dëgjohesh dhe të marrësh orientim për disa tema njëkohësisht: shtëpi, punë, shëndetësi, procedura administrative.

1.5 Shtëpia dhe transporti: të jetosh dhe të lëvizësh

Kërkimi i një shtëpie me qira

Gjetja e një shtëpie është një nga gjërat më të rëndësishme dhe gjithnjë e më e vështirë. Për këtë arsye, është më mirë të dish mirë se çfarë po firmos kur gjen një shtëpi me qira.

Kontrata e qirasë përcakton të drejtat dhe detyrimet e personit që jep shtëpinë me qira dhe të personit që e merr me qira. Një kontratë e rregullt të mbron në mënyra të ndryshme. Para se ta firmosësh, lexoje me qetësi. Nëse diçka nuk është e qartë për ty, sidomos nëse është hera e parë, kërko ndihmë te një sportel kompetent dhe i njohur.

KUJDES NGA MASHTRIMET!

Mos u beso personave që të kërkojnë të dërgosh para përpara se të verifikosh ekzistencën e banesës dhe identitetin e personit me të cilin po komunikon. Ki kujdes edhe ndaj njoftimeve me çmime shumë më të ulëta se ato që zakonisht gjenden në treg dhe ndaj kërkesave për pagesë pa faturë/dokument pagese ose pa një marrëveshje të qartë.

Mos dërgo fotografi të dokumenteve të tua personale ose të dhënave bankare personave që nuk i ke verifikuar.

Ndryshimi i rezidencës

Për të ndryshuar rezidencën duhet të kesh një dokument të vlefshëm që të lejon të banosh në shtëpi, si për shembull një kontratë të regjistruar. Pa të, është e vështirë të marrësh rezidencën, e cila të nevojitet për shumë procedura, edhe për ato që lidhen me lejen e qëndrimit.

Kur transferohesh për të jetuar në një banesë të re, duhet të njoftosh për ndryshimin e rezidencës zyrën e gjendjes civile (anagrafe) të Bashkisë, edhe online. Ky është një hap i rëndësishëm: rezidenca lidhet me aksesin në shumë shërbime (mjeku i familjes, regjistrimi i fëmijëve në shkollë, disa procedura të qëndrimit).

Mbaj mend:

Kur përditëson lejen e qëndrimit, duhet ta paraqesësh lejen e re të qëndrimit në Bashkinë tënde brenda 60 ditëve nga data e rinovimit. Nëse nuk e njofton rinovimin brenda 180 ditëve nga skadimi i lejes së vjetër, Bashkia mund të fillojë procedurën e çregjistrimit zyrtar për shkak të pamundësisë për t'u gjetur ose të mosrinovimit të rezidencës.

Disa fjalë që duhet të njohësh

Proprietario o locatore (pronari ose qiradhënësi): Është personi që vë në dispozicion pronën për t'u dhënë me qira.

Inquilino o conduttore (qiramarrësi ose personi që merr me qira): Është personi që merr me qira shtëpinë ose dhomën.

Canone di affitto (qiraja): Është shuma e parave që qiramarrësi paguan periodikisht, zakonisht çdo muaj, për të jetuar në pronë.

Deposito cauzionale (depozita e garancisë): Është një shumë parash që mund të kërkohet në fillim të kontratës si garanci. Kushtet për kthimin e saj duhet të përcaktohen në kontratë.

Spese condominiali (shpenzimet e përbashkëta të pallatit): Janë shpenzimet që lidhen me administrimin e pjesëve dhe shërbimeve të përbashkëta të pallatit. Zakonisht duhet të paguhen veçmas.

Durata del contratto (kohëzgjatja e kontratës): Kontrata duhet të përcaktojë për sa kohë është e vlefshme dhe cilat janë kushtet e parashikuara për rinovimin e saj.

Registrazione del contratto (regjistrimi i kontratës): Një kontratë qiraje duhet të trajtohet sipas procedurave të parashikuara nga ligji. Regjistrimi është një element i rëndësishëm mbrojtjeje si për qiramarrësin, ashtu edhe për pronarin dhe duhet të bëhet në fillim të kontratës.

Utenze (faturat e shërbimeve): Faturat e sherbimeve janë shërbimet e nevojshme për funksionimin e një shtëpie. Shërbimet kryesore janë energjia elektrike, gazi, uji dhe TARI (mbetjet).

TË DREJTAT



Transporti publik

Në Itali, transporti publik është shumë i rëndësishëm, veçanërisht në qytetet e mëdha. Mund të përdorësh autobusë, tramvaje, metro dhe trena, por edhe trotinetë elektrikë ose biçikleta. Shumë sisteme të transportit publik funksionojnë në nivel provincial dhe shpesh kanë një faqe interneti me të gjitha informacionet e nevojshme për udhëtarët (p.sh. oraret, tarifat, linjat e autobusëve etj.).

Para se të hipësh në një mjet transporti publik, kontrollo se ku mund të blesh biletën, nëse duhet ta kompostosh/validosh dhe për sa kohë është e vlefshme.

Udhëtimi pa një biletë të vlefshme mund të sjellë një gjobë.

1.6 Kur diçka nuk shkon: diskriminimi dhe dhuna, ku të kërkosh ndihmë

Nëse diskriminohesh

Ligji ndalon çdo formë diskriminimi: në punë, gjatë kërkimit të një shtëpie, në jetën e përditshme. Nëse të ndodh, mos qëndro vetëm. Mund t'i drejtohesh një sporteli kundër diskriminimit, i cili mund të të ofrojë mbështetje ligjore dhe të të ndihmojë, nëse dëshiron, të bësh një raportim ose një kallëzim.

Nëse përjeton dhunë

Nëse përjeton dhunë (fizike, psikologjike, ekonomike), veçanërisht dhunë me bazë gjinore ose dhunë në familje, mund t'i drejtohesh një qendre kundër dhunës. Qendrat janë falas. Në kontaktin e parë mund të pyesësh se si do të trajtohen informacionet e tua dhe çfarë ndodh më pas.

Numra të dobishëm:

- **112**: numri unik i emergjencës (policia, karabinierët, ambulanca, zjarrfikësit).
- **1522**: numri kundër dhunës dhe përndjekjes (stalking), falas, aktiv 24 orë në 24 dhe i disponueshëm në disa gjuhë.

Dokumente të dobishme që duhet t'i kesh gjithmonë me vete



Dokument identiteti



Karta shëndetësore (nëse je i regjistruar në SSN) ose kodi STP/karta ENI



Codice fiscale (Numri fiskal)



Kontrata e regjistruar e qirasë (nëse ke një shtëpi me qira)



Leja e qëndrimit (ose dëftesa e aplikimit/rinovimit)



Numri i telefonit të një sporteli ose shoqate të besuar, për rastet kur ke nevojë për ndihmë

2.PUNA.
PUNA NË ITALI, E SHPJEGUAR QARTË



INë Itali, puna rregullohet nga Kushtetuta, ligjet kombëtare dhe **CCNL-të (Kontratat Kolektive Kombëtare të Punës)**. CCNL-të janë marrëveshje midis sindikatave dhe punëdhënësve. Ekziston një kontratë e tillë për çdo sektor (ndërtim, gastronomi, punë shtëpie...) dhe ajo përcakton pagën minimale dhe rregullat bazë.

Një gjë që duhet ta dish menjëherë: kushdo që punon ka të njëjtat të drejta themelore, si e drejta për një pagë të drejtë dhe për kushte të sigurta pune. Nuk kanë rëndësi as kombësia dhe as lloji i permesso di soggiorno (lejes së qëndrimit). Megjithatë, ki kujdes: jo të gjitha lejet e qëndrimit lejojnë punën në të njëjtat kushte. Nëse nuk je i sigurt, kërko informacion në një sportel/shërbim këshillimi përpara se të pranosh një punë.

Kërkimi i punës ndryshon nga një shtet në tjetrin: si shkruhet një CV, si zhvillohet një intervistë pune, si bëhet aplikimi. Faqet në vijim të shpjegojnë kontekstin italian. Përvojat dhe aftësitë që ke fituar diku tjetër kanë rëndësi: këtu do të gjesh si t'i prezantosh ato.

2.1 Kontratat, të drejtat dhe rregullat e pashkruara

Në Itali ekzistojnë tre lloje kryesore të punës. Ato ndryshojnë për sa i përket mbrojtjes që ke dhe mënyrës se si paguhen kontributet (paratë që derdhen për pensionin, sëmundjen dhe papunësinë):

1 **Lavoro dipendente (subordinato)**: lPunon për një punëdhënës, i cili përcakton oraret, detyrat dhe vendin e punës. Merr një pagë fikse çdo muaj, si dhe pushime dhe leje mjekësore të paguara. Kontributet i paguan kompania. Kur marrëdhënia e punës përfundon, merr TFR-në (Trattamento di Fine Rapporto, ose "likuidimin"): një shumë parash që kompania e ka lënë mënjanë për ty. Kjo është forma e punës me më shumë mbrojtje.

2 **Lavoro autonomo (Partita IVA)**: Punon për llogari tënde (për shembull, si zejtar, profesionist i lirë ose ndërmjetës). Ti lëshon faturën për të marrë pagesën. Ti paguan taksat dhe kontributet e tua për pensionin (te "Gestione Separata INPS" ose në një fond të posaçëm të profesionit tënd). Nuk ke pushime dhe as leje mjekësore të paguara.

3 **Lavoro parasubordinato**: Është një formë e ndërmjetme (për shembull, kontratat e bashkëpunimit ose co.co.co.). Bashkëpunon në mënyrë të vazhdueshme me një porositës (personin ose subjektin që të jep punën), por i organizon oraret e tua me më shumë pavarësi. Ke më pak mbrojtje sesa në një punë të varur.

	Lavoro dipendente	Lavoro autonomo	Lavoro parasubordinato
Kush e organizon punën	Punëdhënësi	Ti, në mënyrë të pavarur	Ti, në marrëveshje me personin që të jep punën
Si paguhesh	Pagë fikse mujore (fletëpagesë)	Me faturë, për punën e kryer	Pagesë periodike, e përcaktuar në kontratë
Kontributet	I paguan kompania (një pjesë paguhet edhe nga ti)	I paguan ti drejtpërdrejt (Gestione Separata INPS ose fondi profesional)	I paguan personi që të jep punën, por një pjesë mbahet nga pagesa jote
Pushimet dhe lejet mjekësore të paguara	Po, të garantuara nga CCNL	Jo, nëse nuk ke sigurim privat	Pothuajse asnjëherë: vetëm mbrojtjet minimale të parashikuara nga ligji
TFR (likuidimi)	Po	Jo	Jo
Lloji i kontratës	Kontratë pune në marrëdhënie vartësie	Partita IVA	Kontratë bashkëpunimi (p.sh. co.co.co.)
Shembuj	Punëtor, nëpunës, shitës	Ndërmjetës, zejtar, tregtar	Bashkëpunëtor me projekt, disa shpërndarës (rider) dhe konsulentë

Llojet kryesore të kontratave
(lavoro dipendente)

Nëse punon si punonjës/e, kontrata mund të ketë forma të ndryshme:

- **Tempo indeterminato (me kohë të pacaktuar):** nuk ka një datë përfundimi. Është forma që ofron më shumë stabilitet dhe mbrojtje.
- **Tempo determinato (me kohë të caktuar):** ka një datë përfundimi (një datë të përcaktuar ose përfundimin e një projekti). Megjithatë, ke të drejtë për pushime, leje mjekësore dhe kontribute, por kontrata zgjat për një periudhë të kufizuar, të përcaktuar nga ligji ose nga CCNL.
- **Apprendistato (kontratë praktike/profesionale):** është menduar për ata që hyjnë në tregun e punës ose ndryshojnë sektor. Bashkon punën me trajnimin. Në periudhat e para ka një pagë më të ulët, por të ofron trajnim për një profesion.
- **Part-time (me kohë të pjesshme):** një orar i reduktuar krahasuar me kohën e plotë (për shembull, 20 orë në javë në vend të 40). Paga, pushimet dhe kontributet janë në përpjesëtim me orët e punuara.
- **Somministrazione (punë përmes agjencisë së punësimit).** Punësohesh nga një Agjenci për Punësim (APL), e cila më pas të dërgon për të punuar në një kompani për një periudhë të caktuar. Ke të njëjtat të drejta bazë si një person i punësuar drejtpërdrejt nga kompania.

Kujdes!

Kontrata që firmos duhet të tregojë gjithmonë qartë llojin e kontratës, kohëzgjatjen (nëse parashikohet) dhe klasifikimin profesional (nivelin dhe kualifikimin). Nëse diçka nuk është e qartë, kërko këshillë në një sportel/shërbim këshillimi përpara se ta firmosësh.

Të drejtat e tua themelore

- **Një pagë e drejtë:** nuk mund të jetë më e ulët se minimumi i parashikuar nga kontrata (CCNL) e sektorit ku punon.

- **Busta Paga ose cedolino (fletëpagesa):** e merr çdo muaj. Ajo të tregon sa fiton para taksave (paga bruto), sa taksa paguan dhe sa merr realisht në llogarinë bankare (paga neto). Shumë kontrata parashikojnë një pagë shtesë në dhjetor (paga e trembëdhjetë – tredicesima) dhe, në disa sektorë, një pagë të katërmbëdhjetë në qershor/korrik (quattordicesima).

- **Pushime të paguara:** të paktën 4 javë në vit, përveç pushimit javor.

- **Sëmundja:** njofto punëdhënësin dhe dorëzo certifikatën mjekësore. Gjatë kohës që je i/e sëmurë, punëdhënësi nuk mund të të pushojë nga puna, por kjo mbrojtje vlen vetëm për një periudhë të kufizuar të përcaktuar nga ligji (periodo di comporto).

- **Leja e lindjes dhe atësisë:** nëse je shtatzënë, ndërpret punën para dhe pas lindjes për gjithsej 5 muaj. Kjo quhet leje e lindjes (congedo di maternità) dhe është e detyrueshme. Gjatë këtyre muajve merr rreth 80% të pagës (me një pagë prej 1.500 €, rreth 1.200 €). Nga fillimi i shtatzënisë deri në ditëlindjen e parë të fëmijës, punëdhënësi nuk mund të të pushojë nga puna. Edhe babai ka të drejtë për disa ditë pushim kur lind fëmija: kjo quhet leje e atësisë (congedo di paternità).

- **Periudha e provës:** kur fillon një punë të re, shpesh ka një periudhë prove (kohëzgjatja varet nga kualifikimi dhe CCNL). Gjatë kësaj periudhe, si punëtori ashtu edhe punëdhënësi mund ta ndërpresin marrëdhënien e punës në çdo moment, pa njoftim paraprak dhe pa qenë të detyruar të shpjegojnë arsyen.

- **Siguria në punë:** punëdhënësi duhet të garantojë një mjedis të sigurt pune. Ai duhet të të japë falas pajisjet mbrojtëse (këpucë kundër aksidenteve, doreza, helmetë…), të quajtura DPI. Gjithashtu, duhet të të shpjegojë se si të punosh në mënyrë të sigurt, në një gjuhë që ti e kupton.

- **Liria sindikale:** mund të anëtarësohesh lirisht në një sindikatë (p.sh. CGIL, CISL, UIL, USB). Sindikata është një organizatë që ndihmon punëtorët: të jep këshilla, kontrollon fletëpagesën dhe të mbron nëse punëdhënësi nuk respekton të drejtat e tua.

Të drejtat në rast pushimi nga puna

- **Nëse të pushojnë nga puna:** punëdhënësi nuk mund të të pushojë pa një arsye të vlefshme. Bëhet fjalë për giusta causa (një shkelje e rëndë që lejon ndërprerjen e menjëhershme të kontratës) ose giustificato motivo (për shembull, një problem ekonomik i kompanisë ose një sjellje e papërshtatshme, por më pak e rëndë). Nëse nuk ka njoftim paraprak (shiko fjalorin), punëdhënësi duhet të ta paguajë periudhën e njoftimit. Nëse mendon se pushimi nga puna është i padrejtë, mund t'i drejtohesh një sindikate ose një shërbimi juridik brenda disa muajve nga data e pushimit nga puna: nëse pret shumë, mund të humbasësh të drejtën për ta kundërshtuar.

- **Pas pushimit nga puna:** nëse ke humbur një punë të varur pa dëshirën tënde dhe plotëson kushtet, mund të kërkosh NASpI, kompensimin e papunësisë nga INPS (shiko edhe fjalorin).

PUNA

Çfarë të duhet për të punuar në mënyrë të rregullt

Të duhen dy dokumente:

1. Codice Fiscale (duhet ta kërkosh pranë Agenzia delle Entrate);
2. Permesso di Soggiorno e vlefshme për të punuar (ose vërtetimi i kërkesës së parë për leje qëndrimi/rinovimit, i lëshuar nga Questura ose Posta).

Për të punuar do të të duhet gjithashtu një IBAN (llogari bankare ose librezë postare). Shumë punëdhënës kërkojnë që pagesa të bëhet me transfertë bankare.

.

Çfarë është Modeli UNILAV?

Kur fillon një punë, punëdhënësi yt duhet ta njoftojë Ministrinë e Punës. Ky njoftim quhet UNILAV.

Është i rëndësishëm edhe për ty: është prova zyrtare që puna jote është e rregullt dhe të nevojitet për të kërkuar ose rinovuar lejen e qëndrimit në Questura.

Cilat leje qëndrimi të lejojnë të punosh?

Ndër këto janë disa leje qëndrimi që të japin të drejtën për të punuar:

- Lavoro subordinato,
- Lavoro autonomo,
- Protezione Internazionale (Asilo / Protezione Sussidiaria),
- Protezione Speciale,
- Motivi Familiari,
- Studio (me një kufi maksimal prej 20 orësh në javë dhe deri në 1.040 orë në vit).

Kujdes nga puna "në të zezë" (pa kontratë)

Puna "në të zezë" është puna pa kontratë. Nëse punon në këtë mënyrë, rrezikon shumë:

- nuk paguan kontribute, ndaj do të kesh një pension më të ulët (ose mund të mos kesh fare pension);
- nëse pëson një aksident ose sëmuresh, nuk je i/e mbrojtur;
- nuk mund të kërkosh papunësinë nëse humbet punën;
- nuk mund ta përdorësh atë punë për të kërkuar ose rinovuar lejen e qëndrimit.

Mund të duket si një zgjidhje e shpejtë. Në të vërtetë, mund të krijojë probleme serioze për lejen e qëndrimit dhe të ardhmen tënde.

2.2 Aplikimi për punë: CV-ja, letra e motivimit dhe intervista

Si të shkruash një CV që funksionon në Itali

Curriculum Vitae (CV) tregon kush je, çfarë përvoje ke dhe çfarë di të bësh. Në Itali, formati më i përdorur është CV Europass. Për të krijuar ose përditësuar CV-në tënde, mund të përdorësh dy mjete falas dhe shumë të thjeshta:

- Europass: plotëson modelin online në faqen zyrtare të Bashkimit Evropian (europa.eu).
- JobClinic: regjistrohesh, krijon CV-në në disa hapa dhe e mban gjithmonë të përditësuar nga profili yt.

Çfarë të shkruash në CV-në tënde

- **Të dhënat personale.** Emri, mbiemri, adresa, telefoni dhe e-maili.

  ! Këshillë: shkruaj nëse ke leje qëndrimi dhe patentë shoferi.
- **Gjuhët**. Niveli yt i italishtes (për shembull A2, B1, B2) dhe gjuhët e tjera që njeh.
- **Përvoja e punës**. Fillo me përvojën më të fundit. Shkruaj edhe punët që ke bërë në vendin tënd të origjinës ose gjatë rrugëtimit tënd migrator.
- **Arsimi dhe formimi profesional.** Diplomat, kurset, certifikatat (për shembull HACCP për sektorin e gastronomisë, siguria në punë). Nëse ke bërë ekuivalentimin ose njohjen e një diplome të huaj, shkruaje këtë.
- **Fotoja**. Është fakultative, por në Itali kërkohet. Nëse vendos ta përfshish, zgjidh një foto nga gjoksi e lart, profesionale, me sfond të çelët.
- **Letra e prezantimit (ose letra e motivimit).** Është një tekst i shkurtër, i bashkëngjitur ose i shkruar në përmbajtjen e e-mailit. Tregon kush je, pse po aplikon për atë pozicion dhe cilat janë pikat e tua të forta. Krijon një përshtypje të mirë të parë dhe i jep një prekje njerëzore CV-së tënde.
- **Privatësia (GDPR).** Në fund të CV-së shkruaj: "*Autorizzo il trattamento dei miei dati personali presenti nel CV ai sensi del Regolamento UE 2016/679 (GDPR)." ("Autorizoj përpunimin e të dhënave të mia personale të përfshira në CV, në përputhje me Rregulloren e BE-së 2016/679 (GDPR).")*



PUNA

Përgatitu për intervistën!

Intervista i shërben kompanisë për të të njohur dhe për të vlerësuar aftësitë e tua, por të shërben edhe ty! Intervista është gjithashtu një mundësi për të kuptuar nëse ajo punë është e përshtatshme për ty.



- **Përpara:** informohu për kompaninë për të kuptuar se çfarë prodhon, çfarë shërbimesh ofron...
- **Përpikëria**: mbërrij (ose lidhu, nëse intervista është online) disa minuta përpara orarit.
- **Veshja**: e rregullt dhe e përshtatshme për sektorin; pra, më formale për zyrat dhe më praktike për punët manuale.
- **Dokumentet**: dokument identiteti, codice fiscale, leje qëndrimi (nëse kërkohet), kopje të CV-së.
- **Gjatë intervistës**: përgjigju me sinqeritet. Nëse nuk e kupton një pyetje, kërko me mirësjellje që ta përsërisin më ngadalë.
- **Pyetjet e shpeshta:** bëj një provë me një mik. Ushtrimin e plotë e gjen në pikën 2.4.
- **Pas intervistës:** është normale të mos marrësh përgjigje menjëherë. Mund të pyesësh me mirësjellje se brenda sa kohe do të marrësh një përgjigje. Nëse kalon ajo datë dhe nuk ke marrë asnjë njoftim, dërgo një e-mail të shkurtër falënderimi dhe një kërkesë të sjellshme për informacion. Për shembull: "*Ju falënderoj përsëri për mundësinë dhe doja të pyesja nëse ka ndonjë përditësim lidhur me procesin e përzgjedhjes.*" Kështu tregon interes pa qenë këmbëngulës/e.



PUNA

2.3 Kërkimi i punës: ku, me kë dhe si

Shërbimet dhe sportelet fizike në territor



CPI - Centro per l'Impiego

është zyra publike e dedikuar për punësimin. Këtu mund të regjistrohesh me DID (Dichiarazione di Immediata Disponibilità), e cila vërteton se je i/e papunë, dhe të marrësh orientim falas për punësimin.



APL - Agenzie per il Lavoro

agjenci private të autorizuara nga Ministria (p.sh. Adecco, Randstad, Manpower, Gi Group).



Sportele dhe shoqata të sektorit të tretë

organizata si Caritas, Arci, SAI, qendrat e dëgjimit dhe kooperativat sociale ofrojnë sportele falas për orientimin në punë, përgatitjen e CV-së dhe mbështetjen ligjore për shtetasit e huaj.



Patronatet dhe sindikatat

Janë të dobishme për të kontrolluar nëse kontrata, fletëpagesat dhe procedurat e papunësisë janë të rregullta.

Kujdes!

Regjistrimi dhe kërkimi i punës pranë Agjencive për Punësim është gjithmonë falas. Askush nuk mund të të kërkojë para për të të gjetur një punë.

PUNA

Platformat digjitale dhe aplikacionet



Indeed, InfoJobs, Monster, Subito.it

portalet online më të përdorura në Itali për të aplikuar për oferta lokale pune.

LinkedIn

rrjet profesional ideal për profile të kualifikuara, teknike dhe administrative.



ClicLavoro (cliclavoro.gov.it):

portali i Ministrisë së Punës, i lidhur me CPI-të.

JobClinic (jobclinic.it)

është një platformë digjitale e krijuar posaçërisht për të ndihmuar personat me prejardhje migratore, refugjatët dhe azilkërkuesit të gjejnë punë në Itali. Duke u regjistruar falas, mund të kërkosh oferta pune që përputhen me aftësitë e tua, të dërgosh aplikimin dhe të zhvillosh intervista me kompani të regjistruara në platformë.

JobClinic
www.jobclinic.it



ARTI e Portali Regionali

faqet zyrtare të Rajoneve (si ARTI Toscana ose portalet e Rajoneve të tjera), ku mund të gjesh ofertat e qendrave lokale të punësimit.

2.4 Fletë praktike: intervista, hap pas hapi

Përdore këtë fletë së bashku me një punonjës/e social/e, një mësues/e të italishtes ose një shok/shoqe kursi. Njëri person do të luajë rolin e **rekrutuesit**, ndërsa tjetri rolin e **kandidatit**.

Përpara intervistës: checklist

□ Kam me vete një dokument identiteti, Codice Fiscale dhe lejen e qëndrimit (ose vërtetimin e kërkesës).

□ Kam printuar dhe përditësuar 2 kopje të CV-së sime.

□ E di mirë adresën e takimit dhe mjetet e transportit publik për të mbërritur në kohë.

□ Di ta përshkruaj rrugëtimin tim profesional dhe arsimor në 1–2 minuta.

□ Kam lexuar informacionet kryesore për kompaninë dhe pozicionin për të cilin po aplikoj.

□ Kam menduar të paktën 2 pyetje për t'ia bërë rekrutuesit (p.sh. orari, detyrat, lloji i kontratës).

Pyetje udhëzuese për simulimin

PUNA

Pyetjet e intervistuesit	Sugjerime për përgjigje
Më tregoni pak për veten.	Prezantim i shkurtër (1–2 minuta): si quheni, prej sa kohësh jeni në Itali, çfarë keni studiuar, çfarë pune keni bërë dhe çfarë kërkoni aktualisht.
A keni leje qëndrimi të rregullt që ju lejon të punoni?	Përgjigjuni qartë: "*Po, kam leje qëndrimi për [arsyen], e vlefshme deri më [datën].*"
Pse keni zgjedhur të aplikoni për këtë pozicion?	Tregoni se çfarë ju pëlqen te kjo punë. Shpjegoni çfarë dini të bëni dhe çfarë dëshironi të arrini.
Cilat janë pikat tuaja të forta?	Përmendni 2–3 cilësi konkrete dhe jepni një shembull të vogël praktik për secilën.
Cilat janë pikat tuaja të dobëta?	Përmendni një aspekt real mbi të cilin po punoni. Tregoni se jeni të vetëdijshëm për të dhe se dëshironi të përmirësoheni.
A keni përvoja të ngjashme me këtë punë?	Tregoni çfarë keni bërë, edhe në një shtet tjetër ose në mënyrë joformale.
Kur mund të filloni punën?	Tregoni disponueshmërinë tuaj reale, për shembull:
A keni pyetje për ne?	Bëni 1–2 pyetje konkrete, për shembull: *"Çfarë lloj kontrate parashikohet?"*, "*Cilat do të jenë oraret e punës?*", "*A parashikohet një periudhë orientimi ose trajnimi?*"

Fletë vetëvlerësimi
(Për t'u plotësuar pas simulimit)

Aspekti i vëzhguar	Vlerësimi (1–5) / Shënime
Vetëprezantimi: A shpjegova kush jam dhe çfarë di të bëj?	
Dokumentet: A e shpjegova mirë situatën e lejes sime të qëndrimit?	
Gjuha: A i kuptova pyetjet dhe a u përgjigja qartë?	
Toni dhe qëndrimi: A isha i/e sigurt? A mbajta një qëndrim të mirë trupor?	
Pyetjet: A kërkova sqarime për oraret ose llojin e kontratës?	

Çfarë duhet të përmirësoj për intervistën e ardhshme:

.....

.....

.....

.....

Fjalori i punës

- **Busta paga (or cedolino):** dokumenti që merr çdo muaj. Përmbledh pagën bruto, taksat dhe kontributet e mbajtura, si dhe pagën neto.
- **CAF (Centro di Assistenza Fiscale):** sportel që të ndihmon me deklaratën e të ardhurave (Modeli 730), ISEE-n, bonuset dhe lehtësimet.
- **CCNL:** marrëveshja midis sindikatave dhe punëdhënësve që përcakton, për çdo sektor, të drejtat minimale, oraret dhe pagat minimale.
- **Colloquio di lavoro / CV:** takimi i përzgjedhjes me kompaninë dhe dokumenti që përshkruan përvojën tënde të punës, studimet dhe aftësitë.
- **Congedo di maternità:** ndërprerja e detyrueshme e punës para dhe pas lindjes (5 muaj gjithsej), me rreth 80% të pagës.
- **Congedo di paternità:** ditët e pushimit nga puna që ligji ia njeh babait me lindjen e fëmijës.
- **DPI (Dispositivi di Protezione Individuale):** doreza, helmetë, këpucë kundër aksidenteve, maska. Punëdhënësi duhet t'i sigurojë ato falas.
- **INAIL:** institucioni publik që siguron mbrojtjen kundër aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale.
- **INPS:** institucioni publik që administron pensionet, papunësinë dhe përfitime të tjera.

- **Modello UNILAV:** komunikimi me të cilin punëdhënësi njofton Ministrinë e Punës për fillimin e marrëdhënies së punës. Është dëshmi se puna është e rregullt dhe nevojitet për lejen e qëndrimit.

- **NASpI**: kompensimi i papunësisë nga INPS për personat që humbasin pa dëshirën e tyre një punë si të punësuar.

- **Partita IVA:** numri fiskal që nevojitet për të punuar si i/e vetëpunësuar ose profesionist/e i/e lirë.

- **Patronati**: institucione që të ndihmojnë falas me procedurat e INPS-it (pensionet, NASpI, lejen e lindjes, invaliditetin) dhe INAIL-it, si dhe shpesh edhe me lejet e qëndrimit të lidhura me punën.

- **Periodo di comporto:** koha maksimale e mungesës për shkak të sëmundjes, e përcaktuar nga CCNL-ja, gjatë së cilës e ruan vendin e punës.

- **Periodo di prova**: faza fillestare e marrëdhënies së punës, gjatë së cilës secila palë mund ta ndërpresë kontratën pa afat njoftimi dhe pa dhënë arsye.

- **Preavviso**: koha që kalon nga njoftimi për përfundimin e kontratës deri në ditën e fundit të punës, në rast dorëheqjeje ose pushimi nga puna.

- **Ritenuta d'acconto**: shuma që mbahet nga pagesa dhe i derdhet shtetit si parapagim i taksave, për disa lloje të punës së pavarur.

- **Sindacato**: organizatë (për shembull CGIL, CISL, UIL, USB) që mbron të drejtat e punëtorëve, jep këshillim për fletëpagesën dhe të asiston në mosmarrëveshjet me punëdhënësin.

- **TFR (Trattamento di Fine Rapporto, o "liquidazione")**: shuma që kompania mënjanon gjatë marrëdhënies së punës dhe ta paguan kur kontrata përfundon.

- **Tredicesima e quattordicesima**: paga mujore shtesë e parashikuar nga shumë kontrata, zakonisht në dhjetor dhe në qershor/korrik.

3.PJESËMARRJA

PJESËMARRJA DO TË THOTË TË MARRËSH PJESË

Në seksionet e mëparshme ke parë të drejtat që ke (dhe ato për të cilat ende luftohet) dhe rrugët e mundshme në botën e punës. Tani një pyetje e thjeshtë, që në debatet e mëdha publike dëgjohet pak: çfarë do të thotë, në të vërtetë, të marrësh pjesë?

E drejta e votës dhe shtetësia mbeten themelore. Ato përcaktojnë se kush mund të ndikojë në mënyrë formale në vendimet që prekin të gjithë. Për këtë arsye, ato janë ende në qendër të betejave të mëdha. Këtë e tregojnë përpjekjet e fundit për të reformuar ligjin mbi shtetësinë italiane: ato rihapin pyetjen se kush është “brenda” dhe kush mbetet “jashtë” komunitetit politik dhe shoqërisë, pjesë e së cilës është.

Dhe na kujtojnë një gjë të rëndësishme. Edhe shtetësia, e cila shpesh duket e pandryshueshme dhe e natyrshme, është një ndërtim historik. Ajo ndryshon me kalimin e kohës dhe, bashkë me të, ndryshon edhe se kush përfshihet dhe kush përjashtohet.



PJESËMARRJA

3.1 Çfarë do të thotë të marrësh pjesë?

Për këtë arsye, përgjigjja më e dukshme ndaj pyetjes “Çfarë do të thotë të marrësh pjesë?” (të votosh, të regjistrohesh në një parti, të kandidosh) është e rëndësishme, por nuk mjafton. Është një ide e pjesëmarrjes e lindur në një kontekst të caktuar historik dhe gjeografik. Është vetëm një nga shumë format e jetës së përbashkët. Dhe nuk është masa me të cilën duhet të gjykojmë se kush merr pjesë “mirë” dhe kush jo, sidomos tani që kufiri se kush është qytetar/e dhe, për rrjedhojë, kush mund të votojë, është ende në diskutim.

Mendo për dikë që rritet mes Dakarit dhe Firences, mes Tiranës dhe Milanos, mes Limës dhe Torinos. Ai/ajo mbart me vete ide të tjera për komunitetin, mënyra të tjera për të marrë vendime së bashku, mënyra të tjera për të vepruar. Ja disa shembuj:

- **Teranga** (Senegal):mikpritja si infrastrukturë sociale, jo si një gjest individual. Është pjesëmarrje.
- **Tontine** (shumë diaspora të Afrikës Perëndimore): fonde të përbashkëta për ndihmë reciproke. Janë njëkohësisht pjesëmarrje ekonomike dhe marrëdhënore.
- **Ubuntu** (Afrika Jugore): “unë jam sepse ne jemi”. Nuk është thjesht një fjali për t’u cituar shpejt.
- **Minga** (në disa komunitete të Amerikës Latine): puna e bërë së bashku për të ndihmuar të gjithë komunitetin.
- **Gotong royong** (Indonezi): një parim i ndihmës reciproke. Bashkëpunohet për të përballuar së bashku një nevojë të përbashkët.
- **Ayni** (në shumë komunitete indigjene të Andeve): reciprociteti. Sot të ndihmoj unë ty, nesër më ndihmon ti mua.

Ky seksion nis nga këtu. Pjesëmarrja ka shumë nuanca. Dhe brezat e rinj, me përkatësitë e tyre të shumëfishta, shpesh janë të parët që i eksperimentojnë ato.

3.2 Katër mënyra për të marrë pjesë, përtej kutive të votimit



1 *Pjesëmarrja shoqërore dhe komunitare*

Krijimi i një shoqate, ose anëtarësimi në një të tillë, është një nga mënyrat më konkrete për të ndikuar në zonën ku jeton. Në Itali ka shoqata të krijuara nga dhe për brezat e dytë dhe brezat e rinj: Rrjeti G2, koordinimi CoNNGI, si dhe shumë shoqata lokale ndërkulturore për të rinjtë me prejardhje të ndryshme. Ato krijojnë hapësira të reja, në kufirin mes kërkesës politike, ndihmës reciproke dhe prodhimit kulturor.

2 *Pjesëmarrja informale dhe kulturore*

Një grup që organizon një festival, një blog që hap një debat, një grup që e shndërron një hapësirë të braktisur në një qendër kulturore: kjo është pjesëmarrje në çdo kuptim, edhe pa kaluar përmes ndonjë institucioni. Për shumë të rinj/e, pikërisht këtu, në muzikë, në spoken word, në artin urban, lind për herë të parë një gjuhë publike e përbashkët.

3 *Pjesëmarrja institucionale dhe konsultative*

Shumë të rinj/e kanë familje në dy ose më shumë shtete. Për ta, pjesëmarrja nuk ndalet në kufi. Të kontribuosh në një projekt në vendin e origjinës së prindërve, të jesh pjesë e një shoqate të bashkatdhetarëve që dërgon remitanca kolektive për të ndërtuar infrastruktura lokale, të mbash gjallë rrjete që kalojnë kontinentet dhe brezat: kjo është qytetari aktive. Edhe pse kategoritë juridike italiane kanë vështirësi ta njohin këtë.

4 *Partecipazione istituzionale e consultiva*

Ekzistojnë gjithashtu hapësirat “tradicionale”: klube, librari, kafene, qendra kulturore, biblioteka, qendra lagjesh, këshilla konsultativë, asamble publike, këshilla bashkiakë të hapur, tryeza diskutimi të organizuara nga institucionet.
Janë vende ku takon njerëz të tjerë, zbulon se çfarë ndodh në zonën ku jeton dhe diskuton për problemet e përbashkëta. Ndonjëherë mund t’ua paraqesësh propozimet e tua drejtpërdrejt atyre që marrin vendimet. Pjesëmarrja në këto hapësira të ndihmon gjithashtu të kuptosh se si funksionon zona ku jeton dhe ku mund të ndërhysh.

PJESËMARRJA

3.3 Të marrësh pjesë do të thotë edhe të jesh bashkë

Të marrësh pjesë nuk është vetëm një “detyrë qytetare”. Është gjithashtu një mënyrë konkrete për të bërë miq, për të krijuar rrjet, për t’u ndier pjesë e diçkaje. Nëse mbërrin në një qytet të ri, nëse lëviz mes kulturave dhe gjuhëve të ndryshme, nëse e ke të vështirë të gjesh vendin tënd, pjesëmarrja është një mënyrë praktike për të mos mbetur vetëm/e dhe për të mësuar ose përmirësuar një gjuhë.

Nuk është vetëm “Çfarë mund të bëj unë për komunitetin?”. Është gjithashtu “Çfarë mund të më japë komuniteti, në marrëdhënie, mundësi dhe ndjenjë përkatësie?”



Ja tre mundësi shumë konkrete për të filluar:

Aktivizmi dhe pjesëmarrja aktive digjitale

Nuk është e nevojshme të presësh një asamble për të bërë të dëgjohet zëri yt ose për të gjetur njerëz që ndajnë të njëjtën kauzë. Peticionet online, fushatat në rrjetet sociale, komunitetet në Discord ose Telegram, financimi kolektiv qytetar, gazetaria pjesëmarrëse janë forma aktivizmi që mund të fillohen lehtësisht, shpesh hapi i parë drejt një angazhimi më të strukturuar. Për ata që kanë rrjete në disa shtete, hapësira digjitale është gjithashtu vendi ku komunitetet e largëta qëndrojnë të bashkuara: grupe diasporike, rrjete të të rinjve në qytete të ndryshme, hashtagë që lidhin mobilizimet lokale me kauzat globale.

Hapësirat e socializimit

Para angazhimit të organizuar janë vendet ku takon të rinj të tjerë: qendrat rinore, shtëpitë e popullit, bibliotekat me aktivitete kulturore, hapësirat e rikualifikuara, oratoriet, palestrat popullore, hapësirat sociale të bashkëpunimit. Janë vende informale. Shpesh pikërisht këtu lindin, pothuajse rastësisht, marrëdhëniet që më pas çojnë në një angazhim më të qëndrueshëm.



Trovare associazioni

1. Kur dëshiron të kalosh nga “njohja e njerëzve” te “bërja e diçkaje së bashku” në mënyrë më të qëndrueshme, hapi i ardhshëm është të gjesh shoqatën e duhur. Nëse shoqata që të nevojitet nuk ekziston ende, mund ta krijosh.

PJESËMARRJA

Të marrësh pjesë në jetën e një qyteti do të thotë gjithashtu të dish të kërkosh, të kuptosh dhe të verifikosh informacionin që përdorim për të marrë vendime: për punën, shëndetin, të drejtat, shërbimet publike dhe për atë që ndodh në komunitetin tonë.

Një rregull i thjeshtë: **NDALO – KËRKO – KRAHASO – SHPËRNDAJE**

🛑 **NDALO**: mos e shpërnda menjëherë.

🔎**KËRKO**: gjej burimin origjinal dhe informacione të tjera.

🔄 **KRAHASO**: kontrollo nëse burime të ndryshme raportojnë të njëjtat fakte.

📲 **SHPËRNDAJE**: vetëm pasi ta kesh verifikuar. Ose shkruaj qartë se informacioni nuk është i verifikuar.

Nga mund të filloj të marr pjesë?

- ☐ Kam identifikuar të paktën një mënyrë pjesëmarrjeje që më përshtatet (shoqërore, informale, transnacionale ose institucionale)
- ☐ Njoh të paktën një hapësirë socializimi pranë shtëpisë sime (bibliotekë, qendër rinore, hapësirë sociale bashkëpunimi...)
- ☐ Kam kontaktin e një shoqate ose të një sporteli ku mund të drejtohem për të filluar
- ☐ Di ta zbatoj rregullin NDALO–KËRKO–KRAHASO–SHPËRNDAJE përpara se të shpërndaj një informacion
- ☐ Kam menduar se çfarë do të doja t'i ofroja unë komunitetit dhe çfarë do të doja të merrja prej tij

4.FIRENÇE GJEJ HAPËSIRËN TËNDE NË QYTET!

KU TË SHKOSH, ME KË TË KONTAKTOSH, ÇFARË DUHET TË DISH



🩺 KU TË KËRKOSH NDIHMË PËR SHËNDETIN

- **Azienda Ospedaliero-Universitaria Careggi**

📍 Largo Giovanni Alessandro Brambilla, 3 – 50134 Firenze
☎ 055 794111

- **Azienda USL Toscana Centro – Casa della Comunità D'Annunzio + Servizio STP**

📍 Via Gabriele D'Annunzio, 29 – 50135 Firenze
☎ 055 6934901
☎ Centralino 055 6931111

- **Azienda USL Toscana Centro – Casa della Comunità Le Piagge + Servizio STP**

📍 Via dell'Osteria, 18 – 50142 Firenze
☎ 055 6934221 / 055 6934243
☎ Centralino 055 6931111

- **Azienda USL Toscana Centro – Casa della Comunità Viale Europa + Servizio STP**

📍 Viale Europa, 207/E – 50126 Firenze
☎ 055 6931111

- **Azienda USL Toscana Centro – Casa della Salute Morgagni + Servizio STP**

📍 Viale Morgagni, 33 – 50134 Firenze
☎ 055 6935300
☎ Centralino 055 6931111

- **Azienda USL Toscana Centro – Presidio Canova + Servizio STP**

📍 Via Chiusi, 4/2 – 50142 Firenze
☎ 055 6935406
☎ Centralino 055 6931111

- **Azienda USL Toscana Centro – Presidio Santa Rosa + Servizio STP**

📍 Lungarno Santa Rosa, 15 – 50142 Firenze
☎ 055 6935694 / 055 6935997
☎ Centralino 055 6931111

- **Azienda USL Toscana Centro – Sportello amministrativo Via Chiantigiana + Servizio STP**

📍 Via Chiantigiana, 37 – 50126 Firenze
☎ 055 6931111





- **Consultorio familiare – Canova**

📍 Via Chiusi, 4/2 – Firenze
☎️ 055 6935406
☎️ Centralino 055 6931111

- **Consultorio Familiare Il Campuccio**

📍 Via Villani, 21 – 50124 Firenze
☎️ 055 2298922

- **Consultorio ginecologico-ostetrico – Piero Palagi**

📍 Viale Michelangelo, 41 – Firenze
☎️ 055 6937249
☎️ Centralino 055 6931111

- **Consultorio Giovani – D'Annunzio**

📍 Via Gabriele D'Annunzio, 29 – Firenze
☎️ 055 6934587

- **Consultorio Giovani – Innocenti**

📍 Piazza Santissima Annunziata, 13 – Firenze
☎️ 055 6939907

- **Consultorio Giovani – Le Piagge**

📍 Via dell'Osteria, 18 – Firenze
☎️ 055 6934221 / 055 6934243

- **Gli Anelli Mancanti – Sportello Salute**
- 📍 Via Palazzuolo, 8 – Firenze

- **Misericordia di Firenze – Ambulatori Campo di Marte**

📍 Viale dei Mille, 90 – 50131 Firenze
☎️ 055 212221

- **Misericordia di Firenze – Ambulatori Centro Storico**

📍 Vicolo degli Adimari, 1 – 50122 Firenze
☎️ 055 212221

- **Misericordia di Firenze – Ambulatori Isolotto**

📍 Via del Sansovino, 176 – 50142 Firenze
☎️ 055 212221

- **Misericordia di Firenze – Ambulatori Novoli**

📍 Piazzetta Valdambra, 8 – 50127 Firenze
☎️ 055 212221

- **Misericordia di Firenze – Sede storica**

📍 Piazza del Duomo, 20 – 50122 Firenze
☎️ 055 239393
☎️ Servizi h24 055 212222
☎️ Ambulatori 055 212221

- **Ospedale Piero Palagi**

📍 Viale Michelangelo, 41 – 50122 Firenze
☎️ 055 6931111

- **Ospedale San Giovanni di Dio – Torregalli**

📍 Via Torregalli, 3 – 50143 Firenze
☎️ 055 6932111

- **Ospedale Santa Maria Nuova**

📍 Piazza Santa Maria Nuova, 1 – 50122 Firenze
☎️ 055 69381

- **Salute Mentale Adulti – CSM Q1/Q3**

📍 Viale Giovine Italia, 1/1 – Firenze
☎️ 055 6935505

- **Salute Mentale Adulti – CSM Q2**

📍 Via Gabriele D'Annunzio, 29 – Firenze
☎️ 055 6934409

- **Servizi per le Dipendenze – SerD / Presidio Santa Rosa**

📍 Lungarno Santa Rosa, 15 – Firenze
☎️ 055 6935694 / 055 6935997
☎️ Centralino 055 6931111

- **Servizio Psichiatrico di Diagnosi e Cura – Santa Maria Nuova**

📍 Piazza Santa Maria Nuova, 1 – Firenze
☎️ 055 6938898
Aperto h24

Adresat, numrat e telefonit dhe oraret mund të ndryshojnë me kalimin e kohës. Përpara se të shkosh personalisht, kontrollo gjithmonë të dhënat e përditësuara të kontaktit në faqen e internetit të institucionit ose duke telefonuar.



💼 KU TË KËRKOSH NDIHMË PËR PUNËN

- **ANOLF CISL – Associazione Nazionale Oltre le Frontiere**
📍 Via Carlo del Prete, 135 – 50127 Firenze
☎️ 055 3269029
✉️ anolf.firenze@gmail.com

- **CAF CISL – Firenze Centro**
📍 Via Palazzuolo, 114/R – 50123 Firenze
☎️ 055 214409
✉️ cislpalazzuolo@interfree.it

- **CAF CISL – Sede principale**
📍 Via Carlo del Prete, 137 – 50127 Firenze
☎️ 055 326901
✉️ cisl.sistema.servizi@tin.it

- **CAAF CGIL Toscana**
📍 Via Angelo Tavanti, 3 – 50134 Firenze
☎️ 055 7953111
✉️ callcenter@caaf.tosc.cgil.it

- **CGIL – Camera del Lavoro Metropolitana di Firenze**
📍 Borgo dei Greci, 3 – 50122 Firenze
☎️ 055 27001
☎️ Informazioni/prenotazioni: 055 2700500
✉️ firenze@firenze.cgil.it

- **CISL Firenze-Prato**
📍 Via Carlo del Prete, 137 – 50127 Firenze
☎️ 055 326901





- **Centri per l’Impiego – ARTI Toscana – Firenze Centro**

📍 Via Cavour, 19/R – 50129 Firenze
☎️ 055 19985051
✉️ ci.firenzecentro@arti.toscana.it

- **Centri per l’Impiego – ARTI Toscana – Firenze Isolotto**

📍 Via delle Torri, 23 – 50142 Firenze
☎️ 055 19985052
✉️ ci.firenzeisolotto@arti.toscana.it

- **Centri per l’Impiego – ARTI Toscana – Firenze Mercadante**

📍 Via Mercadante, 42 – Firenze
☎️ 055 19985063
✉️ serviziLavoro.firenze@arti.toscana.it

- **Centri per l’Impiego – ARTI Toscana – Firenze Parterre**

📍 Piazza della Libertà, 12 – 50129 Firenze
☎️ 055 19985053
✉️ ci.firenzeparterre@arti.toscana.it

- **INAS CISL – Patronato**

📍 Via Carlo del Prete, 135 – 50127 Firenze
☎️ 055 3269001 / 055 3269002 / 055 3269003 / 055 3269004 / 055 3269006
✉️ firenze@inas.it

- **INCA CGIL – Patronato**

📍 Borgo dei Greci, 3 – 50122 Firenze
☎️ 055 2700500 / 055 2700563
✉️ firenze@inca.it



- **JobClinic – ItaliaHello ETS**

📍 Via Palazzuolo, 8 – Firenze
Orientamento al lavoro, CV, lettere di presentazione, ricerca attiva, tirocini e formazione.

- **Patronato ACLI – Coverciano**

📍 Via Napoleone Bonaparte, 36 – 50137 Firenze
☎️ 055 613942
✉️ coverciano@patronato.acli.it

- **Patronato ACLI – Firenze Novoli**

📍 Via della Villa Demidoff, 19 – 50127 Firenze
☎️ 055 0982732
✉️ firenzenovoli@patronato.acli.it

- **Patronato ACLI – Isolotto**

📍 Via del Palazzo dei Diavoli, 66 – 50142 Firenze
☎️ 055 0981633
✉️ firenzeisolotto@patronato.acli.it

- **Patronato ACLI – Sede provinciale**

📍 Viale Belfiore, 43/A – 50144 Firenze
☎️ 055 357824
✉️ firenze@patronato.acli.it

- **Sportello immigrati ACLI**

📍 Viale Belfiore, 43/A – 50144 Firenze
☎️ 055 357824
✉️ firenze@patronato.acli.it

- **UIL Toscana / Firenze**
- 📍 Via Vittorio Corcos, 15 – 50142 Firenze
- ☎️ 055 7326199

Adresat, numrat e telefonit dhe oraret mund të ndryshojnë me kalimin e kohës. Përpara se të shkosh personalisht, kontrollo gjithmonë të dhënat e përditësuara të kontaktit në faqen e internetit të institucionit ose duke telefonuar.



😌 KU TË MARRËSH PJESË

- **ACISJF Firenze**
📍 Via Valfonda, 1 – 50123 Firenze, Stazione Santa Maria Novella – binario 5
☎️ 055 294635
✉️ acisjf.firenze@gmail.com

- **ARCI e Circoli ARCI – Comitato Territoriale di Firenze**
📍 Piazza dei Ciompi, 11 – 50122 Firenze
☎️ 055 262970
✉️ firenze@arci.it

- **Arci Comitato Territoriale di Firenze – Circolo ARCI Vie Nuove**
📍 Viale Donato Giannotti, 13 – 50126 Firenze
☎️ 393 9190534
✉️ vienuove@vienuove.it

- **Biblioteca delle Oblate**
📍 Via dell'Oriuolo, 24 – 50122 Firenze
☎️ 055 2616512 / 055 2616523
✉️ bibliotecadelleoblate@comune.fi.it

- **Caritas Diocesana Firenze**
📍 Via de' Pucci, 2 – 50122 Firenze
☎️ 055 267701
✉️ segreteria@caritasfirenze.it

- **Casa del Popolo Galluzzo – ARCI**
📍 Via San Francesco d'Assisi, 1 – Firenze
☎️ 055 2049505 / 331 5881417
✉️ cdpgalluzzo@libero.it

- **Casa delle Donne di Firenze**
📍 Via delle Vecchie Carceri, 8 – Firenze
☎️ 055 218310
✉️ infodonna@comune.fi.it

- **CESVOT – Centro Servizi Volontariato Toscana**
📍 Via Ricasoli, 9 – 50122 Firenze
☎️ 055 271731
☎️ Numero verde 800 005363
✉️ info@cesvot.it





- **Circolo ARCI Porta al Prato**

📍 Via delle Porte Nuove, 33 – Firenze
☎️ 055 26297269

- **COSPE ETS**

📍 Via Scipio Slataper, 10 – 50134 Firenze
☎️ 055 473556
✉️ info@cospe.org

- **EUROPE DIRECT Firenze**

📍 Piazza delle Murate – 50122 Firenze
☎️ 055 244796
✉️ europedirect@comune.fi.it

- **Ex-Fila**

📍 Via Leto Casini, 11 – Firenze

- **Firenze ZAP**

📍 Firenze

- **Gli Anelli Mancanti**

📍 Via Palazzuolo, 8 – 50123 Firenze
☎️ 055 2399533
✉️ glianellimancanti@yahoo.it

- **Informadonna**

📍 Piazza delle Murate – 50122 Firenze
☎️ 055 218310
✉️ infodonna@comune.fi.it

- **Informagiovani Firenze**

📍 Piazza delle Murate – 50122 Firenze
☎️ 055 218310
✉️ infogiov@comune.fi.it

- **Giovani Associazioni – Informagiovani**

📍 Piazza delle Murate – 50122 Firenze
☎️ 055 218310
✉️ infogiov@comune.fi.it

- **LUMEN**

📍 Via del Guarlone, 25 – 50135 Firenze
☎️ 055 3984585

- **Nidiaci**

📍 Via dell'Ardiglione, 30/A – Firenze
☎️ 055 283846
✉️ nidiaci.giovani@comune.fi.it

- **Nosotras APS**

📍 Via Faenza, 103 – 50123 Firenze
☎️ 055 2776326
✉️ info@nosotras.it

- **Progetto Arcobaleno APS**

📍 Via del Leone, 9 – 50124 Firenze
☎️ 055 288150
✉️ arcobaleno@progettoarcobaleno.it

- **Spazio Giovani C.U.R.E.**

📍 Via Faentina, 145 – Firenze
☎️ 055 5522816
✉️ spaziocure@gmail.com

- **Spazi giovani del Comune di Firenze**

📍 Firenze
Rete cittadina di spazi e centri giovani

Adresat, numrat e telefonit dhe oraret mund të ndryshojnë me kalimin e kohës. Përpara se të shkosh personalisht, kontrollo gjithmonë të dhënat e përditësuara të kontaktit në faqen e internetit të institucionit ose duke telefonuar.

RRETH NESH

IPARTICIPATE

https://iparticipate.it/chi-siamo/

L IParticipate u themelua në Firence në vitin 2015 nga një **grup të rinjsh nga vende evropiane dhe joevropiane, shumë prej të cilëve janë lindur dhe/ose rritur në Itali.**
Shoqata u krijua pas një programi trajnimi evropian mbi angazhimin qytetar për anëtarët themelues, dhe kjo ka çuar në **angazhim qytetar dhe aktivizëm social mbi çështjet që prekin të rinjtë me prejardhje migrante dhe më gjerë.**
Ne jemi ata që zakonisht quhen 'brezi i dytë', por përtej këtyre përkufizimeve, ne jemi mishërimi më i qëndrueshëm i një shoqërie gjithnjë e më multikulturore.

ITALIAHELLO

www.italiahello.it

ItaliaHello ETS mbështet komunitetet e **migrantëve, kërkuesit e azilit dhe refugjatët** në përballimin e sfidave me të cilat përballen në udhëtimin e tyre drejt përfshirjes sociale, kulturore dhe ekonomike në Itali.
ItaliaHello fokusohet veçanërisht në aksesin në **informacion** si një mjet kyç për fuqizimin e personave me prejardhje migrante, përmes një platforme dixhitale shumëgjuhëshe (www.italiahello.it) dhe krijimit të paketave me mjete dhe udhëzues mbi tema të rëndësishme për audiencën e synuar.
Gjithashtu, ajo zhvillon **programe për fuqizim dhe mentorim, përfshirje socio-kulturore** dhe integrim në tregun e punës.

GLI ANELLI MANCANTI

https://anellimancanti.com

Gli Anelli Mancanti ofron shërbime mbështetëse për të promovuar përfshirjen sociale dhe **kulturore të personave të disavantazhuar**, përfshirë migrantët, të pastrehët, gratë dhe fëmijët.
Gjithashtu, ajo punon për të nxitur bashkëjetesën paqësore të kulturave, mënyrave të ndryshme të jetesës dhe modeleve të zhvillimit.
Çdo aktivitet synon të promovojë **respektin për qeniet njerëzore,** të kuptuara si individë me të drejta universale dhe si anëtarë të komunitetit që duhet të jenë të informuar, të përfshirë dhe të fuqizuar.

NUK JE VETËM.

Firence është edhe e jotja!

TOOLKIT

Paketa e mjeteve është pjesë e projektit ’ ***Diritti, lavoro e partecipazione - Percorsi per l’autonomia e l’integrazione dei giovani****, i cili synon të rinjtë që jetojnë në qytetin e Firences. Ajo u zhvillua nga IParticipate, ItaliaHello e Anelli Mancanti me mbështetjen e Fondacionit Carlo Marchi.*
Tetor 2026